



Pranuar / Dorezuar Prilipenë / Prilipi Received / Delivered	30.03.2022	2	viti god year
Organ / Objekta Organ / Jedinita Org / Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtopa Prilog Appendix	Sasia Kohëzma Quantity
SKPM/SHCK	1715/2022		111



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Nr. 17 /2022

Datë: 30.03.2022

Në mbështetje të nenit 6 paragrafit 1 nën paragrafit 1.3, nenit 20 paragrafit 2, 4 dhe 5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nenit 10 të Rregullores Nr.01/2018 për Punën e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nenit 3, nenit 4 paragrafit 1 nën paragrafit 1.1, nenit 5, nenit 16 paragrafit 1 dhe 2 të Rregullores Nr.04/2018 për Procedurën e Monitorimit të Institucioneve të Administratës Publike lidhur me Zbatimin të Rregullave dhe Parimeve të Legjislacionit për Shërbimin Civil, si dhe nenin 2 paragrafi 5 të Rregullores Nr.02/2021 për plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores Nr.04/2018, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (*Këshilli*) në mbledhjen e pestë (V) të mbajtur më datë 30.03.2022, mori këtë:


V E N D I M

1. Miratohet Raporti i Kolegjit të Këshillit lidhur me vlerësimin e zbatimit të rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil për vitin 2020 në Zyrën e Presidencës.
2. Sekretari i Përgjithshëm në Zyrën e Presidencës obligohet për zbatimin e rekomandimeve të dhëna në raport, brenda katër dhjetë e pesë (45) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi.
3. Raporti me rekomandime është pjesë e bashkangjitur këtij vendimi.
4. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim pas zbatimit të rekomandimeve.
5. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Këshillit.

Jeton KOCA
Kryetar i Këshillit

Vendimi i dërgohet:

- Sekretarit të Përgjithshëm në Zyrën e Presidencës
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Zyrën e Presidencës
- Arkivin të Këshillit.



Pranuar / Dorezuar Punëhënë/Prodato Received/Delivered	30.03.2022	2	viti god year
Organ dëbësia Organ /Jedinstvo Org /Unit	Nr Prot Pr Prot Prot No	Shtesa e Protog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKRIPSHICK	1715/2022		1117

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

RAPORTI I MONITORIMIT
PËR VITIN 2020

në
ZYRËN E PRESIDENCËS

Prishtinë, 2022

PËRMBAJTJE	2
HYRJE	3
FUNKSIONI I MONITORIMIT	4
OBJEKTIVA DHE METODOLOGJIA E MONITORIMIT	5
FUSHA E MONITORIMIT	6
RAPORTI I MONITORIMIT NË ZYRËN E PRESIDENCËS	7

HYRJE

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (*me tutje referuar si Këshilli*) është institucion i pavarur në kuadër të Kuvendit që siguron respektimin e rregullave dhe parimeve që rregullojnë shërbimin civil.

Për mbikëqyrjen e zbatimit të rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil, Këshilli ka këto funksione themelore:

- *shqyrton dhe merr vendime për ankesat e nëpunësve civil dhe kandidatëve për pranim në shërbimin civil;*
- *monitoron institucionet e administratës publike që kanë të punësuar nëpunës civil, lidhur me zbatimin e rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil.*

Këshilli, funksionet dhe përgjegjësitë themelore i ushtron në pajtim me:

- *Kushtetutën e Republikës së Kosovës;*
- *Ligjin Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës;*
- *Ligjin Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë;*
- *Ligjin Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës;*
- *Ligji Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative;*
- *Rregulloren Nr.01/2018 për Punën e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës;*
- *Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës;*
- *Rregulloren Nr.04/2018 për Procedurën e Monitorimit të Institucioneve të Administratës Publike lidhur me Zbatimin e Rregullave dhe Parimeve të Legjislacionit për Shërbimin Civil;*
- *Rregulloren Nr.05/2018 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.*

FUNKSIONI I MONITORIMIT

Këshilli, krahas funksionit të shqyrtimit dhe vendosjes së ankesave të nëpunësve civil dhe kandidateve për praninë në shërbimin civil, ushtron edhe funksionin e monitorimit të institucioneve të administratës publike lidhur me zbatimin e rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil.

Këtë funksion Këshilli e ushtron në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe dispozitat e Rregullores Nr.04/2018 për Procedurën e Monitorimit në Institucionet e Administratës Publike Lidhur me Zbatimin e Rregullave dhe Parimeve të Legjislacionit për Shërbimin Civil.

Këshilli, përmes ushtrimit të funksionit të monitorimit të institucioneve të administratës publike, mbikëqyrë zbatimin e rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil me qëllim të krijimit të një administratë publike profesionale dhe efektive, sipas standardeve me të mira evropiane.

Funksionin e monitorimit, Këshilli e ushtron përmes monitorimit të rregullt që realizohet sipas planit vjetor të monitorimit, dhe përmes monitorimit të jashtëzakonshëm që realizohet në raste të veçanta që ndërlidhen me shkelje të rënda të legjislacionit për shërbimin civil.

Këshilli, në procesin e monitorimit të institucioneve të administratës publike përgatit raport me të gjetura dhe rekomandime dhe nxjerr vendim, të cilin së bashku me raport ia dërgon institucionit përkatës. Institucioni përkatës i administratës publike është i obliguar për zbatimin e rekomandimeve të Këshillit, brenda afatit të përcaktuar me vendimin e Këshillit.

OBJEKTIVA DHE METODOLOGJIA E MONITORIMIT

Monitorimi i institucioneve të administratës publike ka për qëllim mbikëqyrjen e zbatimit të rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil.

Me qëllim të përmbushjes së përgjegjësiave për realizimin e objektivës sonë kemi zbatuar një kombinim të mostrave sipas gjykimit dhe sipas rastit në përzgjedhjen e dosjeve, dhe jemi mbështetur në një lloj kombinimi të intervistave me zyrtarët e personelit, rishikimeve analitike, rishikimin e dokumenteve dhe verifikimin fizik për të vlerësuar vlefshmërinë dhe rregullsinë e zhvillimit të procedurave dhe respektimin e legjislacionit të shërbimit civil.

FUSHAT E MONITORIMIT

Këshilli, me qellim të ushtrimit të funksionit të monitorimit të institucioneve të administratës publike lidhur me zbatimin e rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil, ka përcaktuar fushat të cilat do të jenë pjesë e monitorimit.

Sipas Rregullores Nr.04/2018 për procedurën e monitorimit në institucionet e administratës publike lidhur me zbatimin e rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil, fushat të cilat monitorohen nga Këshilli janë:

- Organizimi i brendshëm dhe të dhënat e të punësuarve;
- Procedurat e rekrutimit dhe të avancimit;
- Procedurat disiplinore;
- Procedurat e ankesave;
- Procedurat e vlerësimit;
- Procedurat e pushimeve;
- Procedurat e transferimit;
- Të dhënat lidhur me përfaqësimin etnik, gjinor dhe personave me nevoja të veçanta;
- Procedurat e pezullimit, ndërprerjes dhe përfundimit të marrëdhënies së punës;
- Papajtueshmëria në mes të ushtrimit të detyrës së nëpunësit civil dhe funksionarit publik;
- Të dhënat nëse ndaj nëpunësve civil është duke u zhvilluar procedurë penale apo është i dënuar me vendim të gjykatës;
- Trajnimi i nëpunësve civil;
- Vijimi në punë, pagat, shtesat dhe kompensimet;
- Zbatimi i rekomandimeve dhe vendimeve të Këshillit;
- Ngacmimet Seksuale;
- Shënimet/Komentet/Konkluzionet e Përgjithshme për Monitorimin e Zbatimit të Rregullave dhe Parimeve të Legjislacionit për Shërbimin Civil

RAPORT I MONITORIMIT LIDHUR ME ZBATIMIN E RREGULLAVE DHE PARIMEVE TË LEGJISLACIONIT PËR SHËRBIMIN CIVILË NË ZYRËN E PRESIDENCËS PËR VITIN 2020

Këshilli, gjatë procesit të monitorimit të zbatimit të rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil në Zyrën e Presidencës, për të vlerësuar drejtë dhe në mënyrë të paanshme ligjshmërinë e veprimeve të ndërmarra nga zyrtaret përgjegjës të institucionit përkatës, përveç mbikëqyrjes së drejtpërdrejtë që ka zhvilluar gjatë realizimit të vizitës monitoruese me datë 04.02.2022, në prezencë të Udhëheqësit të Njësisë për Burime Njerëzore, si mostra për shqyrtim ka marr një mori të dokumenteve relevante (kopje), si në vijim: Rregulloren (P) Nr.02/2016, për Strukturën Organizative të Presidencës; E-mali i datës 13.11.2020, nga F.z për M. H. lidhur me statusin e nëpunësve civil; Vendimi Nr.3 i datës 24.01.2020, për caktimin e ushtruesit të detyrës se Menaxherit të TI-së; Vendimi me Nr.235/2020 i datës 16.12. 2020, për caktimin e ushtruesit të detyrës se Sekretarit të Zyrës së Presidencës; Plani Individual i Trajnimeve për vitin 2020; Vendimi me numër protokollit 78/2019, i datës 17.06.2019 për Themelimin e Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave; Vendimi me numër protokollit 949 i datës 21.11.2017, për Themelimin e Komisionit Disiplinor; Kërkesë për pushim mjekësor e datës 17.10.2020, se bashku me dëshminë mjekësore; Kërkesë e datës 24.02.2020, për pushim mjekësor se bashku me dëshminë mjekësore; Kërkesë e datës 03.02.2020, për pushim mjekësor, se bashku me dëshminë mjekësore; Kërkesë e datës 18.02.2020, për pushim mjekësor se bashku me dëshminë mjekësore; Kërkesë për pushim mjekësor se bashku me dëshminë mjekësore; Kërkesë e datës 13.01.2020, për pushim mjekësor se bashku me dëshminë mjekësore; Kërkesë e datës 16.10.2020 për pushim mjekësor se bashku me dëshminë mjekësore; Kërkesë e datës 31.11.2020, për pushim mjekësor se bashku me dëshminë mjekësore; Kërkesë e datës 20.01.2020, për pushim mjekësor se bashku me dëshminë mjekësore; Kërkesë e datës 23.11.2020, për pushim mjekësor se bashku me dëshminë mjekësore dhe vërtetimin mjekësor nr.1107 të datës 17.11.2020; Kërkesë e datës 02.03.2020, për pushim mjekësor se bashku me dëshminë mjekësore; Vendimin me nr.644/2016 të datës 16.11.2016 për caktimin Ambasadore në Panama; Vendimi me nr. ZPS-14/15 i datës 30.01.2015, për pezullim të dakorduar; Kërkesë me numër protokollit 08 e datës 05.01.2017 për pezullim e vendit të punës Shkresë me nr.ref:106/2014 e datës 25.08.2014, trajnimi i familjareve të personelit të misioneve diplomatike; Vendimi nr.01/2017 i datës 06.01.2017, për pezullim të punës Plani Vjetor i Trajnimit të Nëpunësve Civil janar-dhjetor 2020; E-mali i datës 14.01.2020, shkresë për menaxheret e personelit, lidhur me hartimin e planit të trajnimit për vitin 2020; Email i datës 23.01.2021 i Menaxheres se personelit per IKAP dërgimi i formularit të trajnimit për vitin 2020' Vendimi me numër protokollit i datës 911 i datës 24.10.2016 për shtesë mbi pagën bazë për mbingarkese në punë; Dosja e nëpunësit për pozitën Administrator i Lartë i TI- së për Sisteme; Dosja e nëpunësit Zyrtar i Lartë për Media; Dosja e nëpunësit Zyrtar i

Prokurimit; Dosja e nëpunësit Kryesues i Prokurimit; Dosja e nëpunësit në pozitën Asistent Administrativ; Dosja e nëpunësit Udhëheqëse e Këshillit Konstitutiv për Komunitete; Formular i të dhënave i datës 10.06.2014; 10.07.2014, Vendimit nr.37/2016 te datës 24.10.2016.

Kolegji i Këshilli, duke u bazuar në provat dhe dëshmitë e shqyrtuara për fushat e monitorimit të përfshira në “pyetësor”, ka konstatuar të gjeturat dhe ka dhënë rekomandimet përkatëse për zyrtarët përgjegjës të institucionit si në vijim:

1. OGANIZIMI I BRENDSHËM DHE TË DHËNAT E TË PUNËSUARVE

Këshilli, gjatë vizitës që ka bërë në Zyrën e Presidencës më datë 04.02.2022, ka konstatuar që ky institucion ka nxjerrë Rregulloren (P)Nr.02/2016 për Strukturën Organizative të Presidencës, në Presidencës e Kosovës e cila është në fuqi nga viti 2016.

Nuk ka të dhëna që Zyra e Presidentit ka filluar me hartimin e Rregullorese se re për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës.

Zyra e Presidentit të Kosovës në vitin 2020 ka pasur gjithsej 82 punonjës të aprovuar sipas Planit vjetor buxhetor për vitin 2020 dhe ka pasur 5 pozita të lira pune.

- Këshilli gjatë vizitës monitoruese ka shqyrtuar pesë (5) dosje të nëpunësve civil dhe atë: dosjen për pozitën *Administrator i Lartë i Teknologjisë Informativë, Kryesues i Prokurimit, Zyrtar i lartë i Prokurimit, Zyrtar i Lartë për Media, dhe Udhëheqëse e Këshillit Konstitutiv për Komunitete.*
- Këshilli duke u bazuar në dëshmitë e ofruara ka konstatuar se në këtë institucion gjatë vitit 2020 ka pasur dy (2) pozita me ushtrues detyre apo zëvendësues të cilat vazhdojnë tutje.
- Sipas deklaratimit të Udhëheqësit të Njësisë së Burimeve Njerëzore si dhe bazuar në dëshmitë e ofruara, Zyra e Presidencës në nëntor të vitit 2020 ka filluar me procesin e deklaratimit të statusit të zyrtarit publik, ndërsa nuk ka dëshmi se deklarimi i statusit është verifikuar nga Departamenti për menaxhimin e Zyrtarëve Publikë.

Këshilli gjatë shqyrtimit të dosjeve ka konstatuar këtë të gjetur:

E GJETURA 1: Këshilli gjatë shqyrtimit të dosjeve të personelit, gjegjësisht mostrave të marra ka gjetur se dosjet e personelit nuk përmbajnë të gjitha kërkesat për pushim të nëpunësit civil dhe formularët për vlerësimin e punës dhe se të njëjta nuk përmbajnë formularin e përmbajtjes së dosjeve personale të nëpunësit civil, respektivisht fletën prezantuese, siç parashihet me dispozitat e nenit 4 paragrafi 3 dhe 4 të Rregullorese (MPB) Nr.01/2020 për Përmbajtjen, Administrimin dhe Përdorimin e Dosjes së Personelit dhe Sistemit Informativ të Menaxhimit të Burimeve Njerëzore.



Me dispozitat e Rregullores (MPB) Nr.01/2020 për Përmbajtjen, Administrimin dhe Përdorimin e Dosjes së Personelit dhe Sistemit Informativ të Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, përkatësisht nenin 4 paragrafi 3 dhe 4 përcaktohet se: 3. *Dosja personale e zyrtarit publikë duhet të shoqërohet nga fleta prezantuese e krijuar nga zyrtari përgjegjës i Njesisë së menaxhimit të burimeve njerëzore e cila ka formën dhe përmbajtjen sipas shtojcës nr. 1.2, bashkëlidhur kësaj rregulloreje;* 4. *Fleta prezantuese sipas paragrafit 3 të këtij neni nënshkruhet nga zyrtari i autorizuar i njesisë së menaxhimit të burimeve njerëzore të institucionit përkatës dhe nga vetë zyrtari publik, për të cilin është krijuar dosja personale.*

Të gjitha institucionet që punësojnë zyrtarë publikë, janë të detyruar të krijojnë dhe administrojnë dosjen personale të çdo të punësuarit në institucionin e tyre (dosja individuale). Dosja personale e zyrtarit publikë është individuale dhe krijohet që nga data e punësimit dhe përmban të dhëna: profesionale, personale, masat disiplinore, vlerësimin periodik të rezultateve individuale në punë, si dhe të dhëna të tjera sipas shtojcës 1.1 të Rregullores (MPB) Nr.01/2020.

Rekomandimi 1: Rekomandojmë Udhëheqësin e Njesisë së Burimeve Njerëzore të Zyrës së Presidencës që të ndërmarr të gjitha veprimet e nevojshme procedurale për eliminimin e shkeljes së lartcekur, në mënyrë që të gjitha dosjet e personelit të jenë në pajtim me dispozitat e Rregullores (MPB) Nr.01/2020 për Përmbajtjen, Administrimin dhe Përdorimin e Dosjes së Personelit dhe Sistemit Informativ të Menaxhimit të Burimeve Njerëzore.

E GJETURA 2: Këshilli, gjatë shqyrtimit të dosjeve të nëpunësve civil dhe sipas deklarimeve të udhëheqësit të njesisë së burimeve njerëzore, ka gjetur se në Zyrën e Presidencës së Kosovës gjatë vitit 2020, ka pas 2 pozita me ushtrues detyre të cilat vazhdojnë tutje. Rrjedhimisht sipas Vendimit me numër protokollit 85 të datës 20.01.2020 të Sekretarit të Përgjithshëm të Zyrës së Presidencës, nëpunësi civil nga pozita Administrator i Sigurisë është emëruar ushtrues detyre i Menaxherit të IT-së, si dhe sipas Vendimit me numër protokollit 1337 të datës 16.12.2020 të u.d. Presidentes së Republikës së Kosovës, nëpunësi civil Drejtor i Departamenti të Protokollit është caktuar në pozitën ushtrues i detyrës së Sekretar të Përgjithshëm të Zyrës së Presidencës, ku baza juridike e nxjerrjes së Vendimit me numër protokollit 85 të datës 20.01.2020 ka qenë Ligji Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil, ndërsa baza juridike e Vendimit me numër protokollit 1337 të datës 16.12.2020 të u.d. Presidentes së Republikës së Kosovës, është neni 14 paragrafi 5 të Ligjit Nr.03/L-094 për Presidentin e Republikës së Kosovës dhe neni 3 të Rregullores (P)Nr.02/2016 për Strukturën Organizative të Presidencës.

57 9 Këshilli nga analizimi i Vendimit me numër protokolli 85 i datës 20.01.2020, ka konstatuar s vendimi në fjalë nuk ka përmban fare afatin ligjor të ushtrimit të përkohshëm të detyrës ashtu siç përcaktohej me nenin 30 paragrafi 4 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, kështu që është tejkaluar afati ligjor i përcaktuar me këto dispozita ligjore. Ndërsa me hyrjen në fuqi të Ligjit Nr.06/L-114 Zyrtarët Publikë nuk është bërë shfuqizimi i këtij vendimi ashtu siç është kërkuar me nenin 83 paragrafi 10 të këtij ligji.

Ndërsa Vendimi me numër protokolli 1337 të datës 16.12.2020 i Presidente së Republikës së Kosovës lidhur me caktimin e ushtruesit të detyrës së Sekretarit të Përgjithshëm me rastin e nxjerrjes se tij nuk janë marrë fare parasysh dispozitat e Ligjit Nr. 06/114 për Zyrtaret Publikë i zbatueshëm nga data 09.07.2020 sipas Aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese me Nr.ref:AGJ 1583/2020, sipas të cilit ligj, personeli Zyrës se Presidencës kanë statusin e nëpunëset civil dhe së te njëjti i nënshtrohet dispozitave këtij ligji.

Këshilli vlerëson së dispozitat e Ligjit Nr.06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura, përkatësisht neni 18 paragrafi 5, neni 19 paragrafi 4 dhe neni 20 paragrafi 3 i referohen rasteve kur pozitave e punës janë të plotësuar me nëpunës civil mirëpo në raste të caktuara kur nëpunësi civil përkohësisht nuk mund të ushtroj detyrën për arsye të ndryshme si p.sh gjendet në pushim vjetor, mjekësor, vizitë jashtë vendi, etj, zëvendësohet nga nëpunësi civil sipas kritereve të përcaktuara me dispozitat e lartcekura ligjore.

Ndërsa dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, përkatësisht neni 32 paragrafi 4 i referohet rasteve të zëvendësimit apo mungesës së përkohshme të nëpunësit civil të përhershëm, dhe ky zëvendësim mund të behet për një periudhe jo më të gjatë se 12 muaj, p.sh zëvendësimi i nëpunësit civil që gjendet në pushim të lehonisë, pushim pa pagesë, etj. Zëvendësimi në rastet e tilla behët përmes procedurave të pranimit që zhvillohen nga Njësia e Burimeve Njerëzore, në pajtim me rregullat e përcaktuara me këtë ligj për nëpunësin administrativ dhe mbështetës.

Plotësimi i pozitave të lira është dashur të bëhet përmes zhvillimit të procedurave të lëvizjes brenda kategorisë apo ngritjes në detyrë siç përcaktohet me dispozitat e nenit 38 dhe 39 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë. Deri në plotësimin e vendit të lirë, organi i punësimit ka mundur të zbatoj procedurat e transferimit të përkohshëm të nëpunësit civil në interes të institucionit, të përcaktuar në nenin 52 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë.

Rekomandimi 2: Rekomandojmë Presidenten e Kosovës dhe Sekretarin e Përgjithshëm të Zyrës se Presidencës se Kosovës që t'i ndërmarr të gjitha veprimet e nevojshme procedurale për eliminimin e shkeljeve të konstatuara në mënyrë që plotësimi i pozitave të lira të behët në pajtim me dispozitat

e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë.

E GJETURA 3: Këshilli, gjatë mbikëqyrjes së zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil në Zyrën e Presidencës ka gjetur se Njësia për Burime Njerëzore ka përgatitur listën e nëpunësve civil dhe deklarimin e statusit të zyrtarëve publik dhe të njëjtën e ka përcjell për verifikim në Departamentin për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë të Ministrisë së Punëve të Brendshme me datë 13.11.2020, mirëpo ende nuk ka përfunduar procesi i deklarimit të statusit të zyrtarëve publikë gjegjësisht nga dokumentacioni nuk ka prova se DMZ-ja ka verifikuar statusin e zyrtarëve publike të Zyrës së Presidencës.

Me dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, përkatësisht nenin 83 paragrafi 16 përcaktohet se: 16. *Deklarimi apo rregullimi i statusit të punësimit të çdo personi, sipas paragrafëve 1- 8 të këtij neni, bëhet me propozim të institucionit dhe me miratimin e Njesisë përgjegjëse, brenda 2 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji. Procedura e deklarimit/rregullimit zhvillohet sipas Ligjit për Procedurën Administrative.* Procedura lidhur me deklarimin e statusit të zyrtarëve publikë është përcaktuar me Rregulloren (QRK) Nr.10/2020 për Deklarimin e Statusit të Zyrtarëve Publikë.

Këshilli, konstaton se deklarimi i statusit të zyrtarëve publik ka qenë obligim ligjor që është dashur të përfundoj brenda afateve ligjore të përcaktuar me dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe Rregullores (QRK) Nr.10/2020 Për Deklarimin e Statusit të Zyrtarëve Publikë.

Rekomandimi 3: Rekomandojmë Udhëheqësin e Njesisë së Burimeve Njerëzore të Zyrës së Presidencës që të përfundojë procesin e deklarimit të statusit të zyrtarëve publikë, sipas dispozitave të nenit 83 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe dispozitave të Rregullores (QRK) Nr.10/2020 për Deklarimin e Statusit të Zyrtarëve Publikë, dhe të sigurohet se deklarimi i statusit të bëhet përmes nxjerrjes së aktit administrativ sipas dispozitave të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

2. PROCEDURAT E REKRUTIMIT DHE TË AVANCIMIT

Këshilli, ka gjetur se kuadër të Zyrës së Presidencës së Kosovës gjatë vitit 2020 nuk është zhvilluar ndonjë procedurë rekrutimi përfshirë edhe procedurat e avancimit dhe se nuk ka pasur të angazhuar nëpunës civil me marrëveshje shërbime të veçanta.

Në këtë fushë nuk ka gjetje dhe rrjedhimisht as rekomandime.

3. PROCEDURAT DISIPLINORE

Këshilli, në proces të monitorimit të zbatimit të rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil, ka gjetur se Zyra e Presidencës përmes Vendimit me numër 57/2019 të datës 21.11.2017 ka të themeluar Komisionin Disiplinor dhe se me hyrjen në fuqi të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrarët publikë nuk është themeluar Komisioni i ri Disiplinor në pajtim me kërkesat e përcaktuara me nenin 49 të të njëjtit ligj.

Gjatë vitit 2020, Komisioni Disiplinor ka iniciuar vetëm një procedurë disiplinore lidhur me ish Sekretarin e Përgjithshëm e vazhduar në vitin 2021.

Me dispozita e nenit 49 paragrafi 1 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrarët Publikë përcaktohet se: *Në çdo institucion, në fushën e veprimit të këtij ligji, themelohet një komision disiplinor me mandat 3 vjeçar, që përfshin së paku një përfaqësues të njësisë përgjegjëse.*

Rregullore (QRK) Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrarëve Publik konkretisht neni 10 ka përcaktuar se: *Çdo institucion i administratës publike i cili ka në marrëdhënie pune nëpunës civilë themelon një komision disiplinor për shqiptimin e masave disiplinore në rast të shkeljeve të rënda disiplinore të parashikuara në nenin 46 paragrafi 3 nënparagrafët 3.1 deri 3.11 të Ligjit. 2. Komisioni disiplinor përbëhet nga tre (3) anëtarë të cilët duhet të jenë nëpunës civilë, nga të cilët njëri duhet të jetë jurist dhe ka këtë përbërje: 2.1. Nëpunës civil i nivelit drejtues – Kryesues i Komisionit; 2.2. Nëpunës civil i nivelit profesional – anëtar dhe 2.3. Nëpunës civil i njësisë së burimeve njerëzore – anëtar....*

Lidhur me këtë fushë Kolegji ka gjetur:

E GJETURA 4: Këshilli ka konstatuar se Zyra e Presidencës nuk ka të themeluar Komisionin Disiplinor ashtu siç kërkohet me nenin 49 paragrafi 1 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrarët Publikë dhe nenin 10 të Rregullores (QRK) Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrarëve Publikë. Komisioni Disiplinor është kompetent në shqyrtimin e fakteve dhe provave të paraqitura dhe shqipton masa disiplinore.

Rekomandimi 4: Rekomandojmë Sekretarin e Përgjithshëm të Zyrës së Presidencës që të themeloj Komisionin Disiplinor në pajtim me nenin 49 paragrafi 1 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrarët Publikë dhe nenit 10 paragrafi 1 dhe 2 të Rregullores (QRK) Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrarëve Publikë

4. PROCEDURAT E ANKESAVE

Këshilli, gjatë procesit të monitorimit të zbatimit të rregullave dhe parimeve që rregullojnë shërbimin civil, ka konstatuar se Zyra e Presidencës së Kosovës sipas Vendimit me numër 78/2019 të datës 17.06.2019, ka themeluar Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave, ndërsa për vitin 2020 ka pasur një (1) ankesë nga ish Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Presidencës kundër vendimit për pezullim në procedurë disiplinore e për te cilat KPMSHCK-ja me vendimin A.nr.430/2020 të datës 15.02.2021 ka aprovuar ankesën si të bazuar.

Në këtë fushë nuk ka gjetje dhe rrjedhimisht as rekomandime.

5. PROCEDURAT E VLERËSIMIT

Këshilli bazuar në deklarinimin e Menaxheres së Personelit ka gjetur se në Zyrën e Presidencës së Kosovës, janë bërë vlerësimet e rezultateve të punës për të gjithë nëpunësit civil për vitin 2020. Gjatë vitit 2020 nuk ka pasur nëpunës civil në periudhë provuese.

Në këtë fushë nuk ka gjetje dhe rrjedhimisht as rekomandime.

6. PROCEDURAT E PUSHIMEVE

Këshilli gjatë monitorimit lidhur me këtë fushë, ka konstatuar se në Zyrën e Presidencës mbahet evidenca pushimeve të nëpunësve civil në kopje elektronike dhe fizike. Gjatë viti 2020 nuk ka pasur pushim pa pagesë dhe pushim të lehonisë. Ndërsa pushimet mjekësore janë të shoqëruara me kërkesë për pushim të aprovuara paraprakisht si dhe shenja mjekësor, kështu që mund të konstatojmë se janë respektuar dispozitat e Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Rregullores Nr.06/2011 për Pushimet e Nëpunësve Civilë, Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, Rregullores (QRK) Nr.12/2020 për Orarin e Punës dhe Pushimet e Zyrtarëve Publikë dhe Ligjit Nr.03/L-212 të Punës.

Në këtë fushë nuk ka gjetje dhe rrjedhimisht as rekomandime.

7. PROCEDURAT E TRANSFERIMIT

Këshilli, gjatë monitorimit në këtë fushë, ka konstatuar se në Zyrën e Presidencës gjatë vitit 2020 nuk ka pasur ndonjë transferim të stafit qoftë brenda apo jashtë institucionit.

Në këtë fushë nuk ka gjetje dhe rrjedhimisht as rekomandime.

8. TË DHËNAT PËR PËRFAQËSIM ETNIK, GJINOR DHE PERSONAVE ME NEVOJA TË VEÇANTA

Në vitin 2020, Zyra e Presidencës së Kosovës ka të punësuar 67 punonjës nga të cilët 42 nëpunës civilë.

- Përfaqësimi gjinor: gjithsej 39 meshkuj nga të cilët 21 nëpunës civil, gjithsej 28 femra ku 21 nëpunëse civile,
- përfaqësimin etnik: 64 shqiptarë, 1 boshnjak, 1 turk, dhe një 1 Goran.

Lidhur me punësimin e personave me nevoja të veçanta Kolegji ka konstatuar se në Zyrën e Presidencës është i punësuar një nëpunës civil me nevoja të veçanta.

E GJETURA 5: Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se në Presidencën e Kosovës nuk ka përfaqësim të barabartë gjinor siç përcaktohet me dispozitat e Ligjit Nr. 05/L-020 për Barazi Gjinore. Po ashtu mungon edhe përfaqësimi i komuniteteve jo shqiptar.

Neni 9 i Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë ka përcaktuar: *Përfaqësimi i komuniteteve Në institucionet publike qendrore, minimum 10% e vendeve të punës në të gjitha kategoritë e zyrtarëve publikë duhet të plotësohen nga pjesëtarët e komuniteteve, të cilat nuk janë shumicë në Kosovë dhe që përmbushin kriteret e pranimit, ndërsa në nivelin komunal, plotësimi i numrit të vendeve të punës për pjesëtarët e komuniteteve bëhet në pajtim me përqindjen e popullatës në atë komunë.*

Rekomandim 5: Rekomandojmë Sekretarin e Përgjithshme të Zyrës së Presidencës, që me rastin e rekrutimit të stafit të ri, të ketë parasysh respektimin e dispozitave të Ligjit Nr. 05/L -020 për Barazi Gjinore si dhe nenin 9 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë.

9. PEZULLIMI, NDËRPRERJA DHE PËRFUNDIMI I MARRËDHËNIES SË PUNËS

Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil bazuar në shkresat e ofruara nga Zyra e Presidencës ka konstatuar se në Zyrën e Presidencës së Kosovës gjatë vitit 2020 ka pasur vetën një (1) pezullim të dakorduar në vazhdim sipas Vendimit Nr. 01/2017 të datës 06.01.2017, për shkak të shoqërimit të bashkëshortes së tij gjatë ushtrimit të misionit diplomatik. Ndërsa nuk ka raste të ndërprerjes dhe përfundimit të marrëdhënies së punës gjatë vitit 2020.

Lidhur me këtë fushë nuk kemi konstatuar të gjetur dhe nuk kemi dhënë rekomandim.

10. PAPAJTUESHMËRIA NË MES TË USHTRIMIT TË DETYRËS SË NËPUNËSIT CIVIL DHE FUNKSIONARIT PUBLIK

Këshilli gjatë shqyrtimit të dosjeve të marra si mostër dhe sipas deklaramit të udhëheqësit të njësisë përgjegjëse ka konstatuar se në këtë institucion nuk ka raste ku nëpunësi civil në të njëjtën kohë mbanë dhe ndonjë post tjetër publik.

Lidhur me këtë fushë nuk kemi konstatuar të gjetur dhe nuk kemi dhënë rekomandim.

11. TË DHËNAT NËSE NDAJ NËPUNËSVE CIVIL ËSHTË DUKE U ZHVILLUAR PROCEDURË PENALE OSE JANË DËNUAR ME VENDIM TË GJYKATËS

Këshilli ka gjetur se në Zyrën e Presidencës së Kosovës në vitin 2020, ka pasur një (1) nëpunës civil ndaj të cilit të cilit ka filluar hetimi penal por që ndaj nëpunësit civil është zhvilluar procedurë disiplinore e vazhduar në vitin 2021 dhe së i njëjti me Vendimin e Komisionit disiplinor i është ndërprerë marrëdhënie e punës në shërbimin civil, i konfirmuar edhe me vendimin e KPMSHCK-së.

Në këtë fushë të monitorimit nuk është gjetur shkelje dhe rrjedhimisht nuk janë dhënë rekomandime.

12. TRAJNIMI I NËPUNËSVE CIVIL

Këshilli ka konstatuar se Njësia për Burime Njerëzore ka përgatitur Planin e Trajnimeve për vitin 2020, dhe se mbahet evidencë lidhur me trajnimet e mbajtura

Në këtë fushë të monitorimit nuk është gjetur shkelje dhe rrjedhimisht nuk janë dhënë rekomandime.

13. VIJIMI NË PUNË, PAGAT, SHITESAT DHE KOMPENSIMET

Këshilli gjatë procesit të monitorimit dhe bazuar në deklaramin e Menaxheres së Personelit, ka konstatuar në Zyrën e Presidencës së Kosovës vijimi në punë mbahet në formë fizike sipas njësive. Nëpunësit civil realizojnë pagën sipas koeficienteve të përcaktuar me akt emërimi.

Ligji 03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civilë me nenin 19 ka përcaktuar se: 1. Institucionet e administratës publike çdo vit, së bashku me kërkesën vjetore për buxhet, dorëzojnë në ministrinë përgjegjëse për financa shumën e nevojshme për mbulimin e shpenzimeve për shtesat mbi pagën bazë në institucionin përkatës. 2. Institucionet e administratës publike çdo vit mund t'i paguajnë shtesa stafit të tyre vetëm me kusht që shuma e përgjithshme e shtesave dhe pagave bazë të jetë përcaktuar

nga ministria përgjegjëse për financa, brenda llogarisë së përgjithshme të përcaktuara për institucionin përkatës.

Rregullorja Nr.33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime të Tjera të Nëpunësve Civilë me nenin 4 ka paraparë: 1. Shtesat mbi pagën bazë janë: 1. Shtesat mbi pagën bazë janë: 1.1. Shtesat për punën me ndërrime; 1.2. Shtesat për kushtet specifike pune dhe 1.3. Shtesat për kushtet e tregu.

Lidhur me këtë fushë kolegji ka gjetur:

E GJETURA 6: Lidhur me shtesat përtej pagës bazë, nga dëshmitë e siguruara, Këshilli ka konstatuar se përveç shtesave të IT që marrin zyrtarët e IT, sipas Vendimit nr.37/2016 të datës 24.10.2016, Drejtori i Departamenti për Çështje Juridike dhe Marrëdhënie Ndërkombëtarë, i emëruar në pozitën e Sekretariatit të Këshillit Kombëtar kundër Korrupsionit, Këshillit Kombëtar për Integrim Evropian dhe Këshillave tjerë që mund të formohen nga Presidenti i Kosovës, i është aprovuar kompensimi mujor prej treqind (300) euro si shtesë mbi pagën bazë për shkak të mbingarkesës në punë, rrjedhimisht Këshilli vlerëson shtesa e aprovuar sipas vendimit në fjalë nuk hynë në asnjërën nga kategoritë e tilla të shtesave përtej pagës bazë andaj dhe si tillë nuk është në pajtim me dispozitat ligjore si me lartë.

Rekomandimi 6: Rekomandojmë Sekretarin e Përgjithshëm të Zyrës së Presidencës që të ndërmerri veprimet e nevojshme administrative që shtesat përtej pagës bazë të jenë në pajtim me Ligjin Nr. 03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civilë dhe Rregulloren Nr.33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime të Tjera të Nëpunësve Civilë

14. NGACMIMET SEKSUALE

Gjatë vizitës së monitorimit nuk na është raportuar asnjë rast në këtë fushë dhe për këtë nuk kemi të gjetur dhe rekomandim.

Për këtë fushë të monitorimit kolegji nuk ka gjetur shkelje dhe nuk kemi rekomandime.

15. ZBATIMI I REKOMANDIMEVE DHE VENDIMEVE TË KËSHILLIT

Gjatë, ka konstatuar se në vitin 2019 nuk ka pasur rekomandime nga KPSHCK-ja pasi që Këshilli nuk ka qenë funksional deri me 12 tetor 2020. Ndërsa sa i për ketë vendimeve të Këshillit, Kolegji ka konstatuar se nuk ka vendime të vitit 2020 të pa zbatuara nga Zyra e Presidencës së Kosovës.

16. SHËNIMET/KOMENTET/KONKLuzionET E PËRGJITHSHËM PËR
MIBKËQYRJEN E ZBATIMIT TË RREGULLAVE DHE PARIMEVE TË
LEGJISLACIONIT PËR SHËRBIMIN CIVIL

Këshilli gjatë shqyrtimit dhe inspektimit të të dhënave të dosjeve për fushat e mbikëqyrjes, ka konstatuar gjashtë (6) të gjetura dhe ka dhënë gjashtë (6) rekomandime.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, rekomandon Menaxhmentin e Lartë të Zyrës së Presidencës, që gjetjet dhe rekomandimet e dhëna në këtë raport t'i adresoj dhe së bashku me njësitë përgjegjëse të sigurojë që të ketë zbatim të plotë të legjislacionit për shërbimin civil, sidomos duke pasur një fokus të veçantë për fushat për të cilat janë evidentuar shkelje dhe lëshime në zbatimin e procedurave dhe legjislacionit për shërbimin civil.

Ardita Haxhnikaj Demi



Kryetar i Kolegjit

Ruslit Kajtazi

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

Raporti i dërgohet:

- Sekretarit të Përgjithshëm të Zyrës së Presidencës;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore të Zyrës së Presidencës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK